



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Shtator, 2019

Përkushtim dhe angazhim i shtuar i SBASHK-ut për trajnimet e licencuara



Interesim i madh i mësimdhënësve në të gjitha komunat e Kosovës

Muaji gusht, edhe pse ishte muaj pushimi, SBASHK-u ka zhvilluar shumë aktivitete në shërbim të anëtarësisë, aktivitete këto e që vazhduan edhe në muajin shtator e do të vazhdojnë edhe në muajt tjerë. Gjatë gjithë kësaj kohe me kërkesën e anëtarësisë janë organizuar shumë trajnime me mësimdhënës nga komunat e Kosovës.

Kështu në komunën e Prishtinës u mbajtën trajnimet "Edukimi ... (faqe 5)

SBASHK-u alarmoi për gjendjen e rëndë në disa shkolla të Kamenicës



Pse kjo heshtje e të tjerëve ?


Që nga momenti i parë kur kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati kishte dalë me idenë për mbyllje shkollash (faqe 4)

Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës vlerëson angazhimet e SBASHK-ut



ETUCE informon anëtarësinë e saj për trajnimet e organizuara

nga sindikata jonë... (faqe 7)



Intervistë me mësimdhënësen dhe veprimtaren sindikale Valentina Sopjani

Me punë dhe përkushtim maksimal drejt sukseseve (faqe 3)

SBASHK-u në Konferencën e ETUCE-së në Bukuresht



Dialogu social dhe barazia gjinore

Në Pallatin Parlamentar të Rumanisë është mbajtur Konferenca përmbyllëse... (faqe 8)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Dita Botërore e Mësuesit



Çdo vit në fillim të tetorit kudo në botë të punësuarit në arsim organizojnë aktivitete dhe takime solemne për të shënuar 5 tetorin-Ditën Botërore të Mësuesit. Është ky një moment i mirë që të bëhet shpalosja dhe rikujtimi i ngjarjeve që kanë të bëjnë me arsimin dhe me armatën e madhe , që angazhohet për dijen e dritën e kundër errësirës.

Kjo datë e veçantë do të kujtohet edhe në Kosovë sikur edhe viteve të tjera me aktivitete modeste, por domethënëse. Në shumë vatra arsimore kësaj feste do t'i kushtohet ora e parë e mësimi dhe mësuesit do të flasin për vlerën e kësaj date, e cila duke u shënuar kudo në botë tregon për solidaritetin e miliona mësimeve, që zërin e tyre e ngasin fuqishëm përmes Unionit të Sindikatave të

Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe Internacionales Botërore të Arsimit (EI).

Kongresi 8 i Internacionales Botërore të Arsimit, që u mbajt në korrikun e këtij viti në Bankok të Tajlandës së largët tregoi se ka shumë probleme e sfida në arsimin e cilit do shtet dhe se kërkohet angazhim i shtuar për tejkalimin e tyre.

Mësuesit e tërë botës do të vazhdojnë me misionin e tyre të shenjtë për edukimin e brezave dhe bashkërisht e duke vazhduar me solidaritetin do të tejkalojnë barrierat e shumta. Ata , pavarësisht sfidave të shumta, do të vazhdojnë të shpërndajnë dije dhe do të luftojnë për dritën kundër errësirës .

Punëtorët e arsimit në Kosovë janë krenar dhe shënojnë me respekt 5 Tetorin – Ditën Botërore të Mësuesit dhe 7 Marsin –Ditën e Mësuesit dhe Shkollës Shqipe.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë,së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë,duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.


Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe veprimtaren sindikale Valentina Sopjani



Me punë dhe përkushtim maksimal drejt sukseseve

Valentina Sopjani është mësimdhënëse e kimisë në shkollën Dardania. Ajo është edhe veprimtare e dalluar sindikale. Ka kohë që është e

angazhuar në cilësinë e trajneres. “Angazhimi në punën si trajnere më ka mundësuar shumë që të marr edhe përvoja të reja të mira sa i përket punës sime”, thotë ajo për t’u shprehur se ndjehet e nderuar për intervistën .

Arsimimi sot:

Kush është Valentina Sopjani?

Valentina:

Fillimisht kam nderin dhe kënaqësinë që më mundësuar të jem pjesë e gazetës së juaj për muajin shtator. Jam Valentina Sopjani e lindur më 17.12.1982 në Prishtinë dhe që nga viti 2009 punoj si mësimdhënëse e Kimisë në SH.f.m.u “Dardania” Prishtinë.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënëses sot?

Valentina:

Nuk e di, ndoshta vështirësi nuk mund të them se ka shumë. Duke bërë krahasimin me vitet paraprake sot ndoshta puna edukativo arsimore është më e lehtë fal zhvillimit profesional të mësimdhënëseve.

Arsimimi sot:

Si ndiheni si trajnere e SBASHK-ut?

Valentina:

Që nga viti që jam angazhuar si trajnere e SBASHK-ut ndihem shumë mirë angazhimi në punën si trajnere më ka mundësuar shumë që të marr edhe përvoja të reja të mira sa i përket punës sime.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni profesionin e mësueses sot?

Valentina:

E vlerësoj dhe e çmoj shumë me punë dhe përkushtim maksimal. Profesionin e mësuesit është më shumë se profesion. Është mision human i edukimit e arsimit të brezave. Është shërbim për dritën kundër errësirës.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?

Valentina:

Mendoj që SBASHK-u është një realitet i suksessit sepse i përshtatet shumë nevojave të mësimdhënëseve. Pra SBASHK, krahas shumë angazhimeve të tjera në shërbim të anëtarësisë, si zë i vërtetë i tyre vazhdimisht punon për t’i aftësuar dhe inkuadruar të gjithë duke u ndjerë të barabartë e sidomos mësimdhënësit në zhvillimin profesional të tyre. Pra, gjithmonë janë afër mësimdhënëseve .

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?

Valentina:

Angazhimi ndoshta për t’ju siguruar sigurim shëndetësor mësimdhënëseve dhe

pensionim në moshën 60 vjeçare

Arsimimi sot:

Çka ju sugjeroni mësimdhënëseve që nuk janë aktiv sa duhet në SBASHK?

Valentina:

Sa më i madh të jetë bashkëpunimi me sindikatën aq më pozitive do të jetë klima dhe puna me ju andaj të gjithë mësimdhënëseve ju them që të jeni sa më afër tyre .

Gjatë muajit

SBASHK-u alarmoi për gjendjen e rëndë në disa shkolla të Kamenicës

Pse kjo heshtje e të tjerëve ?



Që nga momenti i parë kur kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati kishte dalë me idenë për mbyllje shkollash në emër të një farë “reformë”, SBASHK-u ka ngritur zërin dhe ka mbështetur kolegët në këtë komunë, të cilët kanë reaguar arsyeshëm kundër mbylljes së institucioneve arsimore në komunën e tyre e duke arsyetuar këtë kundërshtim të tyre me faktet se ato shkolla nuk kanë nga një e dy nxënës, por shumë më shumë dhe se janë në pjesë malore kufitare dhe shumë larg nga qendra komunale dhe se udhëtimi çdo ditë për në Kamenicë për nxënësit paraqet problem të madh. Kanë reaguar edhe prindërit, por Kastrati nuk është ndalur. Mësimdhënësit në Kamenicë të mbështetur nga SBASHK organizoi edhe protestë para ndërtesës së Kuvendit Komunal në Kamenicë me kërkesat që Kastrati të heq dorë nga ideja e tij e mbylljes së shkollave, por ai nuk reflektoi.



SBASHK-u me qëllim që çështja të zgjidhet si duhet dhe i habitur nga heshtja e institucioneve dhe individëve përgjegjës iu drejtua publikisht liderëve të subjekteve politike dhe kandidatëve për deputetët me apelin që të shkojnë ata në Kamenicë dhe të shohin



nga afër gjendjen dhe të bashkëbisedojnë me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për ta parë vetë të vërtetën. Në këtë apel thuhet:

“Liderë të nderuar Ju që keni marrë besimin e subjekteve politike a koalicioneve që të garoni për kryeministër edhe ju të nderuar që po garoni për të marrë besimin e popullit e për ta përfaqësuar zërin e tij në Parlament e dimë që jeni të angazhuar shumë tani në takim e debate, por Ju lusim shumë shkoni në Kamenicë se nuk mund të jenë dy të vërteta për gjendjen e arsimit atje. Shkoni dhe binduni vetë me realitetin. Liderë të nderuar SBASHK-u nuk është hera e parë që ngrit zërin dhe nuk është as hera e parë që kritikohemi e etiketohemi pa argumente e pa të drejtë. Ne nuk pretendojmë të marrin mandatin e dikujt tjetër, por kemi kryer e do të kryejmë misionin tonë sindikal që të angazhohemi e të reagojmë duke përcjellë në opinion dhe në takime zërin e punëtorëve të arsimit”,



Në apelin e SBASHK drejtuar liderëve dhe kandidatëve për deputet atyre u shpjegohen edhe gjendja atje dhe angazhimet që janë bërë për tejkalimin e situatës.



“Ne reaguam me javë të tëra në takime dhe bashkëbiseda me Kastratin dhe të tjerët dhe jemi shprehur kundër mbylljes së shkollave në Kamenicë. Kundër mbylljes janë shprehur edhe prindërit atje, por Kastrati nuk dëgjoi lutjen tonë që së paku këtë vit ta tërheq vendimin e tij dhe të pres formimin e institucioneve të Kosovës nga vota e lirë e 6 tetorit dhe pastaj çështja të ngrihet në nivel vendi dhe të krijohet një strategji e përbashkët. Ne kundërshtimin tonë të bazuar e shprehëm edhe me protestë para ndërtesës së Kuvendit Komunal në Kamenicë, por Kastrati, i trimëruar nga ish Ministri Bytyqi, nga Bexhet Shala i KMDLNJ-së e ndonjë individë tjetër vazhdon me presione e me lista sipas simpative e tekave për teprica teknologjike, që në të vërtetë janë lista të pushimeve nga puna, vazhdon me presione ndaj drejtorëve. Vazhdon me idenë që shkollat në fshatra

të mbyllën e fëmijët nga atje të bëjnë çdo ditë dhjetëra e dhjetëra kilometra për të shkuar nga fshatrat e tyre malore në Kamenicë.

Nëse realizohet kjo ide e pamatur atëherë këta fëmijë të gjorë, që janë nga klasa e parë e tutje të lodhur nga udhëtimi i gjatë e nëpër rrugët plot kthesa do të shkojnë të molisur në shkollë dhe do të kthehen të stërlodhur në shtëpi në mos i zënë gjumi në autobus. Ju kujtoj se Qeveria e Kosovës dhe Parlamenti kanë aprovuar buxhetin e këtij viti dhe janë paraparë mjete të mjaftueshme pagash për numrin aktual të mësimdhënësve”, për të treguar se SBASHK-u po pret nga Ju dhe nga MASHT të ndërmjetësojë dhe të ofrojë zgjidhje të pranuar. Nëse kjo mungon atëherë ne do të vazhdojmë me reagimet e veprimet tona sepse nuk mund të heshtim karshi një situatë të tillë, që vërtetë është alarmante dhe mund të keqësohet e elektrizohet edhe më shumë “, është thënë në këtë apel.



Përkushtim dhe angazhim i shtuar i SBASHK për trajnimet e licencuara

Interesim i madh i mësimdhënësve në të gjitha komunat e Kosovës



Muaji gusht, edhe pse ishte muaj pushimi, SBASHK-u ka zhvilluar shumë aktivitete në shërbim të anëtarësisë, aktivitete këto e që vazhduan edhe në muajin shtator e do të vazhdojnë edhe në muajt tjerë. Gjatë gjithë kësaj kohe me kërkesën e anëtarësisë janë organizuar shumë trajnime me mësimdhënës nga komunat e Kosovës.



Kështu në komunën e Prishtinës u mbajtën trajnimet "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik". Këto trajnime janë përcjellë nga pjesëmarrësit në shkollën "Dardania" dhe "Ismail Qemali". Ligjërues ishin trajnerët Alban Zeneli, Muhamet Jahiri, Remizie Shahini-Hoxhaj dhe Faton Ismajli. Po në Prishtinë e në shkollën "Zenel Hajdini" është mbajtur trajnimi "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar" udhëhequr nga trajnerja Valentina Sopjani.

Po ashtu në këtë komunë është mbajtur edhe trajnimi "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social" në shkollat "Faik Konica" dhe Elena Gjika", me trajnerët Blendor Shatri dhe Safet Beqiri.



Vlen të theksohet se po vazhdohet me trajnimin në dy grupe "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social" në shkollën "Emin Duraku" me trajnerët Blerim Mehmeti dhe Besim Haliti.



Në komunën e Pejës është mbajtur trajnimi "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajner z Hysen Sogojeva trajnim ky që u mbajt në shkollën "Lidhja e Prizrenit"

Në shkollën "Vllëzerit Frasheri" të Lipjanit janë mbajtur trajnime "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie" me trajnere Igballe Olluri dhe "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" me trajnerët z. Muhamet Jahiri dhe Alban Zeneli.



Në Viti në këtë shkollën "Jonuz Zejnullahu" janë mbajtur dy trajnime si "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm" udhëhequr nga trajneri Atdhe Hykolli, "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" me trajnerët Alban Zeneli dhe Muhamet Jahiri.



Edhe në komunën e Gjakovës janë shtuar kërkesat e mësimdhënësve për trajnime. Këtu janë mbajtur trajnimi "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik", udhëhequr me shumë përkushtim nga Alban Zeneli dhe znj. Blerta Blakaj. Ky trajnim është mbajtur në shkollën "Emin Duraku". Po ashtu në këtë shkollë janë mbajtur edhe trajnimet si "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social" me trajnerët Hysen Sogojeva dhe Blendor Shatri, ndërsa trajnimin "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar" e ka mbajtur trajneri z. Burim Avdijaj.



Në këtë komunë është duke vazhduar edhe trajnimi "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin

Parauniversitar" me trajnere Jehona Oruqi. Në këtë komunë do të mbahet edhe pjesa e dytë e trajnimit "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik", udhëhequr nga trajneret Remizie Shahini Hoxhaj dhe Blerta Blakaj.



Në komunën e Mitrovicës janë mbajtur trajnimet "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" me trajnerët Alban Zeneli dhe Muhamet Jahiri.



Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës vlerëson angazhimet e SBASHK

ETUCE informon anëtarësinë e saj për trajnimet e organizuara nga sindikata jonë

Duke vlerësuar lartë gjithë angazhimet e SBASHK në realizimin e kërkesave të anëtarësisë, e në këtë kuadër edhe trajnimet që po zhvillohen me mësimdhënës nga e tërë Kosova për t'i përgatitur ata sa më mirë në fusha të caktuara, Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) kishte shprehur gatishmërinë që të jetë pjesë e këtij aktiviteti duke bërë edhe një mbështetje, që në shikim të parë duket modeste, por që

është shumë domethënëse. ETUCE ka siguruar fletore, lapsa kimik dhe material tjetër për një numër trajnimesh. Duke e parë se ky aktivitet po zhvillohet me përkushtim dhe po shënon arritje të larta, ETUCE informon anëtarësinë e saj për trajnimet e organizuara nga sindikata jonë. Kjo ka domethënie të veçantë për ne sepse aktivitetet e organizuara nga SBASHK bëhen

të njohura për miliona anëtarë të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës .

Për ju lexues të dashur po sjellim në vazhdim shkrimin në origjinal botuar në faqen zyrtare të ETUCE që i dedikohet për lexim gjithë sindikatave anëtare nga e tërë Evropa.

<https://www.csee-etu.org/en/news/archive/3209-etuce-supports-sbashk-in-delivering-professional-development-for-teachers-in-kosovo>

ETUCE supports SBASHK in delivering professional development for teachers in Kosovo

Published: 16 September 2019



By playing an active role in training and professional development, education trade unions support their members in their work and defend the status of teaching as an independent profession. Three new courses for the members of SBASHK in Kosovo have been currently supported by ETUCE in the framework of the bilateral cooperation agreement signed in July 2019.

The United Trade Union of Education, Science and Culture of the Republic of Kosovo (SBASHK) is

organising 18 training sessions by the end of 2019, covering the following topics:

Media education and its role in social and democratic development. Participants practice a critical analysis of the methods and perspective of various media, developing their awareness that not all media output can be taken at face value.

Strengthening capacities for effective leadership of social dialogue. This course teaches participants how to use collective negotiation and agreements to solve violations of education workers' rights.

Strategic leadership and planning in pre-university education. Participants acquire relevant skills for leadership in education, so that they can undertake strategic planning and develop their own leadership methodologies.

Courses are being delivered by professional trainers and coordinated by the school, municipal and national levels of SBASHK. All courses offer 32 hours of training, which teachers in Kosovo need to get their license or for re-licensing.

SBASHK's President, Rahman Jasharaj, and Training Coordinator, Ymer Ymeri, visited some of the sessions and were impressed by the enthusiastic interest shown by the participants. The participants also offered positive feedback on the quality of courses and the work of the trainers.

Mr Jasharaj commented that *"We have made many commitments and made many achievements in the service of our membership. One of these commitments is the successful organisation of trainings for our colleagues throughout Kosovo. The continuing support of ETUCE in all our union commitments is important. Therefore, the achievements are the fruit of mutual commitment."*

"I have thanked many times the European Director of ETUCE, Susan Flocken, for the continuing support that ETUCE is giving to SBASHK for our members' interest but also for raising the quality of education."

"Thank you ETUCE - together for new achievements!" said the SBASHK President at the end of the current phase of the new training programme.

SBASHK-u në Konferencën e ETUCE-së në Bukuresht

Dialogu social dhe barazia gjinore

Në Pallatin Parlamentar të Rumanisë është mbajtur Konferenca përmbyllëse e ETUCE-së me temën : **Sindikatat e Arsimit që adresojnë barazinë gjinore përmes dialogut social**, më 16 dhe 17 shtator 2019. Kjo konferencë përmbylli një projekt 2-vjeçar të

ETUCE-së për barazinë gjinore dhe dialogun shoqëror, i cili u bashkëfinancua nga Komisioni Evropian.



Takimin e hapi kryetarja e ETUCE-së Christine Blower, duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit, ndërsa drejtorja Evropiane e ETUCE-së Susan Flocken e bëri hapjen e punës së Konferencës duke deklaruar se : "Barazia gjinore nuk është çështje e veçantë që sindikatat e arsimit mund të trajtojnë veçmas nga temat e tjera. Ndryshimet e fundit socio-ekonomike në Evropë, përhapja e shpejtë e teknologjisë digjitale, migracioni dhe përhapja e ligjërimeve politike të krahut të djathtë dhe nacionalist, të gjitha kanë një ndikim të rëndësishëm në përpjekjet tona për të ndërtuar një sektor arsimit që është i drejtë për gratë dhe burrat. Në ETUCE, ne mbështesim organizatat tona anëtare në përpjekjet e tyre për të adresuar pabarazitë gjinore duke u siguruar atyre mjete dhe burime konkrete. Ne gjithashtu punojmë së bashku për të adresuar sfidat e gjata dhe në zhvillim përmes dialogut social në nivelin institucional, kombëtar dhe evropian. Ne mund të jemi krenarë për punën që kemi realizuar bashkërisht në këtë projekt. Sidoqoftë, puna jonë për barazinë gjinore vazhdon pasi mbetet në zemër të aktiviteteve tona. "

Barazia gjinore është një çështje thelbësore për mësuesit dhe sindikatat e arsimit. Ne duhet ta përfshijmë atë në të gjitha fushat e punës sonë ngase kjo përfshin politikat e brendshme të sindikatave.



Pjesëmarrësit në këtë konferencë diskutuan disa çështje të nxehta të pabarazisë gjinore në sektorin e arsimit dhe shkëmbyen mjete praktike për ta adresuar atë. Në veçanti, ata hulumtuan mënyrat për të prezantuar aspektin e barazisë gjinore në dialogun shoqëror dhe kontrata kolektive me punëdhënësit.



Në këtë ngjarje, përfaqësuesit e organizatave anëtare të ETUCE nga 29 vende evropiane debatuan me politikëbërësit evropianë dhe ekspertët e barazisë gjinore. Adresimi i çështjeve të tilla domethënëse si stereotipet gjinore, seksizmi dhe mungesa e trajnimit fillestar të mësuesve për barazinë gjinore, si dhe zgjidhje të sugjeruara për përshpejtimin e përparimit të Evropës drejt barazisë gjinore.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Përfaqësuesja e SBASHK-ut Vlora Rexhepi Berisha, pati mundësinë të takohet me shumë kolegë nga sindikatat pjesëmarrëse në këtë Konferencë dhe të bisedojnë për së afërmi rreth çështjes së barazisë gjinore, sfidat dhe përvojat rreth kësaj çështjeje.

Po ashtu në këtë Konferencë pati edhe Panairë të Praktikave të Mira, ku pjesëmarrësit gjithashtu ndanë punën e sindikatës së tyre për promovimin e barazisë gjinore në profesionin mësimor dhe në shoqëri në tërësi. Praktikatat e paraqitura janë ndër shumë shembuj konkret dhe të suksesshëm të përfshirë në bazën e të

dhënave të reja online në ETUCE. Për më tepër, gjatë seancave interaktive të grupeve të punës, pjesëmarrësit patën diskutime të frytshme të cilat vërtetuan Planin e Aksionit ETUCE për Barazi Gjinore.



Vazhdohet me trajnimet për anëtarët e SBASHK

Kësaj radhe trajnime të shumta në Ferizaj e Pejë



Këto trajnime kanë rinisur në muajin gusht dhe është shënuar pjesëmarrje e lartë edhe pse ishte kohë pushimesh. Po ashtu muaji shtator ka shënuar mbajtjen e një numri të madh në shumë nga komunat e Kosovës. Anëtarët e SBASHK-ut kanë mundësi deklarimi se a duan fillimisht ta përcjellin trajnimin : “ Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “ Edukimi media dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”, “ Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”, “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” apo “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

SBASHK-u ka rinisur me trajnimet nëpër komunat e Kosovës duke plotësuar kështu kërkesat e shumta të mësimdhënësve për këtë aktivitet, që konsiderohet tepër i rëndësishëm ngase ndihmon pjesëmarrësit për arritjen e njohurive të reja nga çështjet që ofrojnë 5 trajnimet e licencuara dhe po ashtu ndihmon ata që të kenë sa më shumë orë trajnimesh, të cilat kërkohen për licencat dhe në të ardhmen edhe për gradimet.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Derisa në disa komuna do të mbahet pjesa e dytë e trajnimeve të parapara sipas agjendës, në komunat tjera do të nisët me këto 5 trajnime. Kësaj radhe janë Ferizaj dhe Peja që do të organizojnë më shumë trajnime.



Në Ferizaj gjatë këtij vikendi do të zhvillohen trajnimet “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “ Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “ Edukimi media dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik” dhe “Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”.



Në Pejë po ashtu do të zhvillohen trajnime në disa grupe dhe atë: “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “ Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “ Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik” dhe “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Po kështu në Shtime dhe në Mitrovicë do të mbahet trajnimi : “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Vlen të theksohet se nga pushtimet verore deri me tani janë certifikuar rreth njëmijë anëtarë të SBASHK-ut.

Kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM në këto komuna janë zotuar se do të angazhohen për të krijuar ambiente pune dhe kushte të duhura për realizimin me sukses të këtyre trajnimeve, kurse trajnerët janë të gatshëm të dëshmojnë përkushtimin sikur edhe gjatë trajnimeve të tjera që janë mbajtur deri tani.

